



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MEMALIAJ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1861 prot.

Memaliaj më 21. 08. 2025

RELACION

ËNDA: Për zgjedhjen e Nënkyetarit të Këshillit Bashkiak Memaliaj

Në përputhje me nenin 54 e vijues të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe me Rregulloren e Këshillit Bashkiak Memaliaj, pas vakancës në kryesinë e këshillit bashkiak që përbëhet nga një nënkryetar, është e nevojshme zgjedhja e nënkryetarit tjetër. Ky funksion ka rëndësi të veçantë për garantimin e funksionimit normal të Këshillit Bashkiak, duke siguruar ndihmë të drejtpërdrejtë Kryetarit në drejtimin e mbledhjeve, organizimin e punës, si dhe përfaqësimin e Këshillit në rast mungese ose pamundësie të Kryetarit dhe nënkryetarit.

Bazuar në propozimet e këshilltarëve dhe në diskutimet e zhvilluara gjatë mbledhjeve u propozohet që në këtë detyrë të zgjidhet nënkryetari i dytë që i përket opozitës. Pasi nënkryetar aktual është bashkuar grupit socialist që përbën shumicën në këshill.

Miratimi i nënkryetarit të dytë të këshillit do të mundësojë funksionimin e plotë të organeve të drejtimit të Këshillit Bashkiak dhe ushtrimin efektiv të kompetencave të tij, në përputhje me ligjin dhe rregulloren e brendshme.

Konceptoi:

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Erjola Allka

